



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2368, datë 10.10.2013

Për

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për portabilitetin e numrit””

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | | |
|----|-------------|------------|----------|
| 1. | Znj. Alketa | Mukavelati | Kryetare |
| 2. | Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. | Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 4. | Znj. Elkeda | Domi | Anëtare |
| 5. | Znj. Zamira | Nurçe | Anëtare |

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 10. 10. 2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, mori në shqyrtim çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për portabilitetin e numrit”,

BAZA LIGJORE:

1. Neni 1, 2, 106 dhe ne vijim i Kodit të Procedurës Administrative (KPrA);
2. Neni 110, 114 dhe 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”*);
3. Rregullore nr. 13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, datë 07.04.2010 e ndryshuar, (*Rregullore nr. 13*);

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi Projektaktin “Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Për performacën e bazës së ë dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit””;
2. Dokumenti për Këshillim Publik;
3. Projektvendim i Këshillit Drejtues të AKEP i formatuar dhe arsyetuar;
si dhe,
4. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se :

1. Grupi i punës i ngritur sipas Urdhërit nr. 1010, datë 22.08.2013 me qëllim zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në aktet normative rregullatore dhe kryerjen e procesit të këshillimit publik në kuadër të mbykqyrjes së ofruesit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar, ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e Këshillit Drejtues dokumentin për këshillim publik “Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për portabilitetin e numrit”;
2. Dokumentin për Këshillim Publik është hartuar për të evidentuar edhe nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike nëse shërbimi i bazës së të dhënave referencë e centralizuar ofrohet mjaftueshëm, nëse funksionimi duhet ndryshuar ose shtuar ndonjë funksionalitet dhe nëse persona të tjerë juridikë janë të interesuar të ofrojnë bazën e të dhënave referencë;
3. Duke marrë në konsideratë çështjet e diskutuara me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike në takimet e kryera nga AKEP-i që nga fillimi i portabilitetit të numrit, në vitin 2011 e deri në takimin e fundit më datë 28.08.2013 me operatorët e telefonisë fikse dhe të lëvizshme:
 - Numri i operatorëve të ofrimit të shërbimit të portabilitetit që janë të lidhur me CRBD;
 - Shtimi i kërkesave të operatorëve që kërkojnë të lidhin sistemet e tyre në mënyrë automatike me CRBD.
4. Nga pikpamja thelbësore propozimi është përgatitur bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, në nenin 110 te ligjit 9918, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 10 të Rregullores nr. 13 “Për portabilitetin e Numrit”, ku përcaktohet se:

“Jo më vonë se 3 (tre) vjet AKEP-i do të rishikojë nëpërmjet këshillimit publik nëse baza e të dhënave referencë e centralizuar ofrohet mjaftueshëm, nëse funksionimi duhet ndryshuar ose zgjeruar dhe nëse personat e tjerë juridikë janë të interesuar të ofrojnë bazën e të dhënave referencë të centralizuar”

5. Dokumenti për këshillim publik i shërben qëllimit të përmirësimit, në ofrimin e shërbimit të CRDB të portabilitetit të numrit dhe zgjerimin e mënyrës së operimit të CRDB.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e nxjerrjes së këtij dokumenti, për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike bazuar në nenin 110, 114 dhe 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 10 të Rregullores nr. 13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar;

V E N D O S:

1. Të miratojë për këshillim publik dokumentin “Për performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për portabilitetin e numrit”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Periudha e këshillimit publik do të jetë 30 ditë nga data e publikimit të dokumentit në internet në faqen zyrtare të AKEP;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkedo DOMI
4. Zamira NURÇE

DOKUMENTI PËR KËSHILLIM PUBLIK

Për

“Performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për Portabilitetin e Numrit”

1. AKEP bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, bazuar në pikën 5 të nenit 10 të Rregullores nr. 13 “Për portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar, ku përcaktohet se:
“Jo më vonë se 3 (tre) vjet AKEP-i do të rishikojë nëpërmjet këshillimit publik nëse baza e të dhënave referencë e centralizuar ofrohet mjaftueshëm, nëse funksionimi duhet ndryshuar ose zgjeruar dhe nëse personat e tjerë juridikë janë të interesuar të ofrojnë bazën e të dhënave referencë të centralizuar” dhe nisur nga diskutimet e bëra lidhur me procesin e bartjes së numrit dhe mënyrës së funksionimit të CRDB, bën këtë këshillim publik në lidhje me funksionimin e CRDB, me qëllim marrjen e të gjitha opinioneve të mundshme nga palët e interesuara.

Referuar raporteve të gjeneruara dhe evidencave të mbajtura, AKEP vlerëson se baza e të dhënave referencë e centralizuar ofrohet mjaftueshëm

Pyetje: A jeni te njejtit mendim me AKEP, argumentat tuaja lidhur me këtë çështje?

2. AKEP vlerëson se funksionimi dhe teknologjia e aplikuar e CRDB ka qenë e kënaqshme.

Pyetje: A keni koment lidhur me funksionimin dhe teknologjinë e përdorur? Nëse mendoni se funksionimi duhet ndryshuar ose zgjeruar ju lutemi argumentat tuaj.

3. AKEP, vlerëson se niveli i bashkëpunimit midis AKEP, ofruesit të CRDB dhe operatorëve që përdorin këtë sistem ka qenë i një niveli të kënaqshëm.

Pyetje: A jeni i të njejtit mendim me AKEP, argumentat tuaja lidhur me këtë çështje duke i bashkëngjitur dhe rastet kur keni komunikuar me AKEP apo me ofruesin e CRDB ?

4. AKEP mendon se shërbimi që ofrohet nga CRDB është gjithë përfshirës.

Pyetje: A jeni i të njejtit mendim me AKEP, argumentat tuaja lidhur me këtë çështje dhe nëse keni propozime të tjera?

5. AKEP bazuar në pikën 5 të nenit 10 të Rregullores nr.13 “Për Portabilitetin e Numrit” e ndryshuar, kërkon të evidentojë nëse ka interes nga persona të tjerë juridik, për të qenë ofrues të bazës reference të centralizuar.

Informacion për këshillimin publik

AKEP, me qëllim zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në aktet normative rregullatore dhe kryerjen e procesit të këshillimit publik në kuadër të mbikqyrjes së ofruesit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar, ka hartuar dokumentin për këshillim publik *“Për performacën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për portabilitetin e numrit”*.

Ky Dokument Këshillimi është i disponueshëm në faqen e Internetit të AKEP <http://www.akep.al>.

Te gjithë te interesuarit lidhur me kete dokument keshillimi publik mund ti drejtohen AKEP per t’ju vene ne dispozicion materiale te tjera ndihmese, qe do ti ndihmoje ne realizimin e qellimit ne kete keshillim.

Palët e interesuara që dëshirojnë të shprehin opinionet e tyre në lidhje me këtë Dokument Këshillimi ftohen të depozitojnë komentet e tyre me shkrim në AKEP.

Afati i dërgimit të komenteve nga palët është deri më 14 . 11. 2013.

Komentet në lidhje me këtë Dokument Këshillimi mund të dërgohen në një osë disa nga mënyrat dhe adresat e mëposhtme:

- a) E-mail : info@akep.al
- b) Dërgim me postë (të printuar dhe kopje elektronike):

AKEP
Adresa: Rr. “Abdi Toptani”,
Godina Torre Drini, K. IX,
Tiranë